

VENDIM
Nr.575, datë 14.7.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS QENDËR PISKOVË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.1238, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Piskovë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Piskovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Piskovë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-11,13-24	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
27-31	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
32-47,50-60,62-67	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
48,49,61,68-71,76-80	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
72,73	Prona që përdoret për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
75	Prona që përdoren për shërbime sociale.	Në pronësi
81-174,175-184	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
186,187	Prona që përdoret për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
227,229,250,252	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
262,263,269,270	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të trata	Në pronësi

	dhe toka jo produktive).	
--	--------------------------	--